



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 30 Prill 2021

Dokument parlamentar
(Komision përgjegjës)

R A P O R T

MBI

**DEKRETIN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NR. 13 017 DATË 12.04.2021,
“PËR KTHIMIN E LIGJIT 46/2021 “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN “PËR DISA
SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.98/2016, “PËR ORGANIZIMIN E
PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””**

I. HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni për Çështjet Ligjore, - këtej e tutje*), në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 30.04.2021 (zhvilluar me video-conference), mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 13017 datë 12.04.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni për Çështjet Ligjore caktoi relatore për shqyrtimin e dekretit deputeten Vasilika Hysi.

Presidenti i Republikës bazuar në nenin 85, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka depozituar pranë Kuvendit, Dekretin nr. 113017 datë 12.04.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Bazuar në nenin 86, të Rregullores së Kuvendit, ky dekret, është futur automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me cilësinë e komisionin përgjegjës, bazuar në nenin 86, dhe 32-38 të Rregullores së Kuvendit, e merr në shqyrtim këtë dekret vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës, ndaj edhe shqyrtimi i tij do të fokusohet vetëm në këto dispozita.

2.0 DISKUTIMI I DEKRETIT TË PRESIDENTIT NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE

Në mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e Dekretit ishin të pranishëm nga Institucioni i Presidentit të Republikës: z. Bledar Dervishaj, Këshilltar i Presidentit për Çështjet Ligjore, dhe znj. Katrin Treska, Drejtoreshë e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike. Përfaqësuesit e Presidentit të Republikës paraqitën në Komision argumentet për kthimin për rishqyrtim të ligjit.

2.1 Baza ligjore për shqyrtimin e Dekretit

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë:

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht. Dekreti i Presidentit për rishqyrtim ligji futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit.

2. Dekreti për kthimin e ligjit për rishqyrtim bëhet pjesë e rendit të ditës të mbledhjes më të parë.
3. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura në arsyetimin për kthimin e ligjit nga Presidenti i Republikës.
4. Komisioni përgjegjës përgatit raportin për seancën plenare me propozimin për pranimin ose rrëzimin e dekretit të Presidentit brenda 4 javëve nga data e depozitimit të tij në Kuvend. Në rastin e pranimit të dekretit, raporti përmban formulimet për nene të veçanta të ligjit.
5. Dekreti për kthim për rishqyrtim të ligjit bëhet pjesë e rendit të ditës të seancës plenare, por jo më parë se 48 orë.
6. Seanca plenare e shqyrton dekretin për kthim për rishqyrtim të ligjit vetëm për arsyet e kthimit të tij.
7. Kuvendi në seancë plenare voton me shumicën e kërkuar në Kushtetutë për pranimin ose rrëzimin e dekretit.
8. Në rast pranimi të dekretit, Kuvendi voton në parim propozimet që komisioni përgjegjës ka paraqitur në raport. Kuvendi voton vetëm nenet që reflektojnë propozimet e miratuara në komision, si dhe bëhet votimi në tërësi për ligjin.
9. Ligji i votuar në tërësi mban numrin që ka marrë me miratimin e parë, kurse data do të jetë e votimit më të fundit në tërësi.

2.2 Arsyet për kthimin e ligjit sipas Dekretit të Presidentit të Republikës

Presidenti i Republikës në arsyetimin e tij për kthimin e ligjit në mënyrë të përmbledhur ka arsyetuar si më poshtë vijon:

- Procedura e propozimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr. 46/2021, bie ndesh me nenin 4, pikat 2 dhe 3 dhe 83, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, objekt shqyrtimi është propozuar, prezantuar dhe shqyrtuar në kushte kur vullneti i organit ligjvënës provohet se ka qenë fiktiv dhe i paracaktuar/diktuar nga qeveria duke shkelur kështu parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të parashikuara nga neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 46/2021, përmes nenit 2, 3 dhe 6 deformat standartin e deritanishëm të konsoliduar në sistemin gjyqësor, sa i takon formimit të trupave gjyqësore në shqyrtimin e çështjes, parimin e sigurisë juridike, parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit, dhe atë atë të realizimit të një procesi të rregullt ligjor.

2.3 Diskutimi dhe shqyrtimi i arsyeve të kthimit të ligjit

Komisioni për Çështjet Ligjore, përmes relatores deputetes Vasilika Hysi bëri një analizë të detajuar të dekretit të Presidentit në gjithë elementët e tij, duke vlerësuar se asnjë prej këtyre pretendimeve nuk janë të argumentuara dhe të bazuara.

Lidhur me pretendimin se procedura e propozimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjit nr. 46/2021, bie ndesh me nenin 4, pikat 2 dhe 3 dhe 83, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, relatorja solli argumentet e mwposhtme:

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në datën 25 shkurt 2021 nga deputetja propozuese Klotilda Bushka, në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës. Ky projektligj është shqyrtuar dhe miratuar nga komisioni përgjegjës për çështjet ligjore në datën 19 mars 2021, pra 3 javë pas depozitimit të projektligjit në Kuvend.

Projektligji nuk është shqyrtuar me procedurë të përshejtuar, por në përputhje me kërkesat e nenit 69, pika 3 të Rregullores së Kuvendit, i cili përcakton se *shqyrtimi i projektligjeve nuk mund të fillojë pa kaluar të paktën dy javë nga data e paraqitjes së tyre, me përjashtim të rasteve kur në këtë Rregullore përcaktohet ndryshe.*

Komisioni përgjegjës për Çështjet ligjore i ka kushtuar kohën dhe vëmendjen e duhur shqyrtimit të projektligjit duke e konsultuar atë me Ministrinë e Drejtësisë, Inspektoriatin e Lartë të Drejtësisë, Këshillin e Lartë Gjiqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës, Prezencën e OSBE-së në Tiranë, misionin ndërkombëtar “EURALIUS” dhe Departamentin e Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane, OPDAT.

Thënë gjithë sa më sipër, pretendimi i Presidentit të Republikës është i pa bazuar dhe i pavërtetë.

Lidhur me pretendimin se ligji nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, objekt shqyrtimi është propozuar, prezantuar dhe shqyrtuar në kushte kur vullneti i organit ligjvënës provohet se ka qenë fiktiv dhe i paracaktuar/diktuar nga qeveria duke shkelur kështu parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve të parashikuara nga neni 7 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, argumentojmë si më poshtë vijon:

Ky argument i Presidentit të Republikës, është jo i saktë dhe nuk qëndron pasi, nga ana e Kuvendit të Shqipërisë janë ndërmarrë të gjitha procedurat dhe konsultimet e nevojshme konform kërkesave ligjore.

Projektligji është propozuar nga deputetja nismëtare në përputhje me nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe është shoqëruar me relaconin përkatës sipas nenit 68 të rregullores së Kuvendit. Kushtetuta, në nenin 81, paragrafi 1 parashikon se të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet si dhe 20 mijë zgjedhës.

Projektligji është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit menjëherë sapo është depozituar nga deputetja nismëtare në Kuvend.

Projektligji është konsultuar me ekspertë të misionit ndërkombëtar EURALIUS dhe Departamentin e Drejtësisë pranë Ambasadës Amerikane, OPDAT, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e paketës ligjore të Reformës në Drejtësi.

Projektligji është konsultuar gjithahshtu me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të cilat Kushtetuta e vendit i ka ngarkuar për të siguruar pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. është përfshirë në procesin e konsultimit të projektligjit Prezenca e EURALIUS në Shqipëri e cila ka depozituar mendimet në komisionin përgjegjës për çështjet ligjore, sapo projektligji është publikuar në faqen e Kuvendit.

Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar përcakton detyrimin e Këshillit të lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë të shprehim mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin që mund të ndikojë në punën e gjyqësorit dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e këshillit (neni 93 dhe 187 i ligjit). Një nga detyrat e secilit këshill është dhënia e mendimit mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë respektivisht në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë ose të drejtësisë në përgjithësi, duke ju drejtuar një ministri ose organi tjetër (neni 93, paragrafi 3 dhe nëni 187, paragrafi 3).

Sa më sipër, përfshirja e këshillave respektive në analizën e problematikave të dala në praktikë gjatë zbatimit të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, adresimi i propozimeve për ndryshime ligjore dhe konsultimi i tyre nga Komisioni për Çështjet Ligjore, është kushtetues dhe në zbatim të ligjit dhe rregullores së Kuvendit dhe në përputhje me frymën dhe praktikën e mira të Kuvendit për pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në vendimmarrje dhe në procesin e konsultimit publik.

Relatorja solli në vëmendje të Komisionit dhe të përfaqësuesve të Institucionit të Presidentit faktin se e gjithë reforma në drejtësi dhe paketa e ligjeve të hartuara në kuadër të kësaj reforme është përgatitur me asistentë të profesionistëve të fushës, ekspertë dhe akademikë dhe projektligjet janë depozituar nga deputetë/e të Kuvendit. Depozitimi i nismës nga deputetët jo vetëm që është në përputhje me Kushtetutën, por edhe me rregulloren e Kuvendit dhe praktikën e mira të tij.

Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar ka përcaktuar në disa nene të tij marrëdhënien midis Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë. Kështu, në nenet 71, pika 1 dhe 169, pika 1 të ligjit përcaktohet se *koordinimi, zhvillimi dhe zbatimi i politikave shtetërore dhe i*

strategjisë sektoriale të sektorit të drejtësisë bëhet nga Ministri i Drejtësisë. Ai është përgjegjës për përgatitjen e projektakteve ligjore në fushën e drejtësisë, për të cilat merr edhe mendimin e Këshillave. Në nenin 81, pika 1 dhe 180 të ligjit parashikohet se Këshillat, në bashkëpunim me Ministrin e Drejtësisë, hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë një plan strategjik për sistemin gjyqësor dhe sistemin e prokurorisë në përputhje me objektivat e të këtij ligji, dhe në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë.

Sikurse është nënvizuar më sipër, ligji, në nenet 93 dhe 187 të tij parashikon gjithashtu përgjegjësinë e Këshillave për të shprehur mendime dhe për të bërë propozime lidhur me ndryshimet në legjislacionin, që mund të ndikojë në punën e gjyqësorit dhe prokurorisë si dhe çdo çështje tjetër që është nën përgjegjësinë e tyre. Sipas ligjit, Këshillat:

- a) *shqyrtojnë funksionimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative;*
- b) *bëjnë rekomandime për ndryshimin e rregullave të procedurës gjyqësore civile, penale ose administrative;*
- c) *japin përgjigje për kërkesat e ardhura nga ministrat për të dhënë mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat, mbi sistemin e prokurorisë dhe të drejtësisë në përgjithësi;*
- d) *japin mendim mbi një projektligj ose ndonjë çështje tjetër që mund të ndikojë mbi sistemin gjyqësor ose gjykatat, mbi sistemin e prokurorisë dhe atë të drejtësisë në përgjithësi duke ia drejtuar një ministri ose ndonjë organi tjetër.*
- e) *Këshillat i propozojnë Ministrin të Drejtësisë ushtrimin e nismës për ndryshime ligjore në lidhje me çdo çështje që është nën përgjegjësinë e tyre.*

Bashkëpunimi ndërinstytucional i aktorëve të sistemit të drejtësisë rregullohet në nenin 170 “Bashkëpunimi ndërinstytucional i aktorëve të sistemit të drejtësisë”, pika 1, sipas të cilit Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të paktën 1 herë në vit, organizojnë mbledhje të përbashkëta për shkëmbimin e përvojave, për unifikimin e interpretimit dhe zbatimit të ligjeve, lidhur me ushtrimin e funksioneve dhe organizimit të tyre, si dhe të çështjeve të përgjithshme të lidhura me funksionimin e sistemit të drejtësisë.

E gjithë paketa ligjore e Reformës në Drejtësi, që prej fillimit të saj, është hartuar nga ekspertë të nivelit të lartë të drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe partnerët e kësaj reforme EURALIUS dhe OPDAT. Këto ndryshime ligjore janë depozituar nga deputetë të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Metodologjia e ndjekur për paketën ligjore të Reformës në Drejtësi, në përqasje me ligjin nr. 46/2021 të kthyer nga Presidenti, është e njëjtë.

Sa më sipër ky ligj është miratuar në konsultim me të gjitha institucionet e pavarura dhe organizatave ndërkombëtare të angazhuara në këtë fushë në kuadër të gjithpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik dhe se çdo sugjerim nga shoqëria civile ishte i mirwpritur.

Lidhur me pretendimin se ligji nr. 46/2021, përmes nenit 2, 3 dhe 6 deformon standartin e deritanishëm të konsoliduar në sistemin gjyqësor, sa i takon formimit të trupave gjyqësore në shqyrtimin e çështjes, parimin e sigurisë juridike, parimin e

pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit, dhe atë të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, evidentojmë sa më poshtë vijon:

Së pari, duhet theksuar fakti se Presidenti i Republikës në dekret ka pretenduar se nenet më sipër të ligjit 46/2021, deformojnë standartin e deritanishëm të konsoliduar në sistemin gjyqësor, sa i takon formimit të trupave gjyqësore në shqyrtimin e çështjes, parimin në sigurisë juridike, parimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjyqësorit, dhe atë të realizimit të një procesi të rregullt ligjor, por këto janë pretendime të përgjithshme dhe në fakt nuk evidentohet as edhe një dispozitë e shkelur e Kushtetutës, që të justifikojë shkeljen e parimeve kushtetues.

Megjithatë për të bërë një analizë, lidhur me cenimin ose jo të këtyre elementëve kushtetues, analizojmë si më poshtë vijon:

Sa i takon qëndrimit të Presidentit të Republikës se nenet 2, 3, dhe 6 nuk i japin zgjidhje përfundimtare problematikave të konstatuara, sjellim në vëmendje se këto nene kanë si qëllim pikërisht t'i japin zgjidhje situatave të krijuara nga procesi rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në kushtet kur sistemi gjyqësor është përballur me vakanca të theksuara të cilat kanë sjellë vonesa në shqyrtimin e çështjeve dhe mbingarkesa në punën e gjyqtarëve, është synuar që përmes këtyre ndryshimeve të ofrohen zgjidhje efikase, të cilat e bëjnë sistemin eficient duke garantuar dhënien e drejtësisë kundrejt qytetarëve në sa më shpejt dhe duke reflektuar kështu edhe pavarësinë dhe profesionalizmi që qytetarët presin nga sistemi gjyqësor i reformuar.

Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

Një gjykatë e cila nuk ka në përbërje të saj numrin e nevojshëm të gjyqtarëve nuk mund të japë drejtësi dhe as nuk mund të gjykojë në kohë dhe brenda afateve procedurale. Për ta bërë gjykatën eficiente dhe për të garantuar dhënien e drejtësisë janë kryer ndërhyrjet e parashikuara nga nenet 2, 3 dhe 6, të cilat synojnë që të tejkalojnë vështirësitë dhe vonesat e krijuara për t'i dhënë zgjidhje atyre me qëllim garantimin e të drejtave të qytetarëve, por pa cenuar të drejtat e tyre në kuadër të procesit të rregullt ligjor.

Në lidhje me balancën ndërmjet të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm si një nga garancitë e procesit të rregullt ligjor dhe nevojës për kolegjalitetin në marrjen e vendimeve.

Theksojmë se kërkesat e sipërcituara janë marrë parasysh në procesin e hartimit të ndryshimeve dhe ndërhyrjet janë hartuar në mënyrë të kujdesshme duke ruajtur balancën ndërmjet tyre. Konkretisht, në nenin 2, është ndryshuar pika 5, ku sipas së cilës degët e gjykatave gjykojnë vetëm çështje të cilat nuk janë urgjente, si dhe çështje civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm dhe gjykimi i çështjeve tregtare nuk është pjesë e

kompetencës së shqyrtimit gjyqësor nga degët e gjykatave. Ndryshimi i bërë në këtë pikë parashikon që degët e gjykatave të gjykojnë çështjet civile dhe penale që gjykohen nga një gjyqtar i vetëm. Pra, në thelb ruhet të njëjtat të drejta dhe parime të procesit të rregullt ligjor por me ndryshimin që rritet numri i çështjeve të cilat mund të gjykohen në degët e gjykatave. Kjo pasi degët e gjykatave sipas parashikimit të mëparshëm kishin një numër të kufizuar çështjesh në gjykim që lidhen me urgjencën dhe llojin e tyre të cilat në situatën e tanishme nuk kontribuojnë sa duhet në përballimin e çështjeve në ngarkim të gjyqtarëve.

Gjykimi nga degët e gjykatave edhe të çështjeve urgjente dhe atyre tregtare nuk e prish ekuilibrin midis nevojës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe nevojës për kolegjalitetin në marrjen e vendimeve. Kjo pasi sa i takon kolegjalitetit gjithsesi degët do të vazhdojnë të gjykojnë çështje të cilat gjykohen nga një gjyqtar i vetëm siç ishte parashikuar më parë. Gjykimi i çështjeve urgjente atyre tregtare edhe nga degët e gjykatave nuk cenon aspektet e procesit të rregullt të sipërcituara pasi në thelb çështjet urgjente do të trajtohen në mënyrën e duhur tashmë duke garantuar që ato të gjykohen brenda një afati sa më të shkurtër. Nëse këto çështje nuk gjykohen edhe në degët e gjykatave, rrezikojnë që të mos gjykohen brenda afateve të duhura duke qenë se ka vakanca në gjykatat përkatëse dhe kanë gjyqtarët kanë mbingarkesë të madhe e sjell zgjatje të afateve dhe nuk i lejon të trajtohen me urgjencën e duhur këto çështje.

Nga ana tjetër çështjet tregtare do të përfshihen në çështjet të cilat gjykohen edhe nga degët e gjykatave pasi në thelb gjykimi i tyre nuk ndryshon nga gjykimi i çështjeve të tjera, por gjithsesi edhe këtu do të ruhet kolegjaliteti i gjykimit pasi në degët e gjykatave do të gjykohen çështjet tregtare të cilat gjykohen në gjykata nga një gjyqtar i vetëm dhe nëse sipas parashikimeve të ligjit procedural nevojitet që gjykimi të kryhet nga trupa gjyqësore me më shumë se një anëtar atëherë ato nuk do të gjykohen në degë.

Kështu kolegjaliteti i gjykimit nuk cenohet por arrihet rezultati final, ai i gjykimit të çështjeve brenda afateve dhe uljes e shpërndarjes së ngarkesës së gjyqtarëve duke e bërë gjykatën më eficiente.

Sa i takon uljes së cilësisë në vendimmarrjen gjyqësore apo mosdhënies së drejtësisë, ky pretendim nuk qëndron pasi përgatitja profesionale e gjyqtarëve si në gjykatë si në degët e gjykatës është e njëjtë. Nga ana tjetër edhe pasoja e pretenduar për mosdhënien e drejtësisë nuk qëndron pasi qëllimi i këtyre ndërhyrjeve në thelb është pikërisht dhënia e drejtësisë si qëllim primar dhe respektimi i afateve procedurale duke pasur parasysh se një drejtësi e vonuar është drejtësi mohuar.

Mbi numrin e anëtarëve të trupave gjyqësore në gjykatat e apelet dhe në Gjykatën e Lartë

Ndryshimi i parashikuar në nenin 24 synon nga njëra anë harmonizimin e dispozitave të ligjit 98/2016 me dispozitat e ligjeve procedurale dhe nga ana tjetër shkon në të njëjtin drejtim me sa është argumentuar më sipër. Nevoja urgjente për gjykimin e çështjeve brenda

afateve procedurale për të dhënë drejtësi sa më shpejtë dhe ajo për një gjykim të drejtë, objektiv dhe të paanshëm garantohet përmes ndryshimeve të nenit 24 pasi edhe në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë do të ruhet përbërja e trupës gjyquese me tre ose pesë anëtarë sipas rasteve të parashikuara nga ligji procedural.

Siç është evidentuar nga përfaqësuesit e gjyqësorit, nisur nga karakteri i tyre disa çështje nuk justifikojnë ngritjen në gjykatën e apelit të një trupe prej tre gjyqtarësh pasi mund të gjykohen edhe nga një gjyqtar i vetëm (psh. paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore apo kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake) pa cenuar as të drejtën e palëve për një proces të rregullt ligjor dhe as cilësinë dhe paanësinë e vendimmarrjes së gjykatës. Profesionalizmi dhe vlerësimi objektiv është përgjegjësi e çdo gjyqtarit për çdo çështjeje që i paraqitet për shqyrtim pavarësisht karakterit të saj apo përbërjes së trupit gjyqësor. Pra, rolin kyç në përcaktimin se cilat çështje gjykohen nga një gjyqtar i vetëm dhe cilat nga një trup gjyqësor me disa anëtarë, e luan karakteri i çështjes dhe rëndësia e saj në raport me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Nga sa evidentohet nga parashikimi i këtij ligji në raport parashikimet në ligjet procedurale, rezulton se është ruajtur balanca midis nevojës për të gjykuar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të çështjeve sipas karakterit të tyre dhe nevojës për gjykimin e çështjeve me përbërjen e nevojshme të trupave gjyqësore që i përgjigjet rëndësisë së tyre.

I njëjti qëndrim është mbajtur në ndryshimin e përbërjes së trupave të kolegjeve të Gjykatës së Lartë. Duke patur në vëmendje rolin që tashmë luan kjo gjykatë lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore është është parashikuar një trupë gjyqësore e përbërë me 5 gjyqtarë, ndërsa për gjykimet e tjera me 3 gjyqtarë. Këto ndryshime synojnë të rrisin efektivitetin dhe shpejtësinë e Gjykatës së Lartë në trajtimin e çështjeve duke ndikuar në uljen e numrit të çështjeve të pagjykuara nga kjo gjykatë dhe dhënien e drejtësisë.

Pra edhe kjo ndërhyrje që lidhet me përbërjen e trupit gjyqësor synon që të garantojë drejtësi efektive për palët por edhe respektimin e kërkesave për një proces të rregullt ligjor brenda afateve, duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor garantohet cilësia dhe profesionalizmi i trupës gjyqësore duke qenë se në apel dhe në Gjykatën e Lartë rritja e cilësisë dhe profesionalizmi garantohet jo vetëm nga numri por edhe nga kriteret për emërimin e gjyqtarëve në këto gjykata.

Në lidhje me parimin e sigurisë juridike

Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, “siguria juridike” si element i shtetit të së drejtës, ka si kërkesë të domosdoshme që ligji në tërësi apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Për të kuptuar dhe zbatuar drejt parimin e sigurisë juridike, kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t’i drejtojnë veprimet e tyre

në mënyrë korrekte e në përputhje me të dhe, nga ana tjetër, vetë ligji të mos qëndrojë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti. Një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit t'i japë asaj kuptime të ndryshme dhe që sjell pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma (vendimet nr. 9/2007, nr. 36/2007 dhe nr.10/2015) të Gjykatës Kushtetuese)

Ndryshimi i trupave në shkallët e gjyqësorit i përgjigjet pikërisht interesit publik të shoqërisë e cila kërkon një sistem që përmbush qëllimin primar të tij, dhënien e drejtësisë. Aktualisht sistemi gjyqësor gjendet në kushtet kur gjykatat nuk janë në gjendje të japin drejtësi për shkak të tejzgjatjes së afateve të gjykimit që vijnë si pasojë e mungesës së gjyqtarëve dhe ngarkesës së jashtëzakonshme me të cilët përballen gjyqtarët aktualë.

Ngarkesa në vetvete ndikon direkt në cilësinë dhe profesionalizmin e drejtësisë për shkak se gjyqtarët gjenden në vështirësi objektive nga njëra anë për të shqyrtuar në mënyrë të thelluar çështjet duke i dhënë atyre kohën e nevojshme dhe nën presionin e kërkesës për respektimin e afateve procedurale. Nga ana tjetër reforma në drejtësi ka rritur besimin e qytetarëve në sistem. Tashmë qytetarët e shohin gjykatën si një institucion i cili mund t'i japë drejtësi atyre dhe i drejtohen asaj për duke sjellë një rritje të atyre që i drejtohen gjykatës për zgjidhje të problematikave. Pikërisht për t'iu përgjigjur këtij interesi publik madhor, ligjvënësi dhe organet e drejtësisë nuk mund të qëndrojnë indiferentë por duhet të luajnë një rol proaktiv për të adresuar interesin publik për një sistem gjyqësor funksional.

Sa i takon profesionalizmit, efektivitetit, paanshmërisë dhe cilësisë së vendimmarrjes

Ndryshimet në ligjin nr. 98/2016 kanë qenë minimale, pa cenuar thelbin dhe parimet udhëheqëse të reformës në drejtësi dhe as standardet të cilat janë dakordësuar me partnerët ndërkombëtare, të cilët kanë asistuar në punën për ndryshimet ligjore. Ishin pikërisht organet e sistemit gjyqësor dhe problematikave të evidentuara prej tyre ato që sollën ndërhyrjen në ligj, por gjithmonë duke treguar kujdesin e duhur për të mos ndryshuar thelbin dhe parimet themelore të gjykimit. Cilësia, pavarësia dhe paanshmëria e trupave gjykues nuk garantohej thjesht dhe vetëm nga numri por nga një sërë aspektesh të tjera që lidhen me parashikimet procedurale, statusin dhe ndërtimin e sistemit të drejtësisë në tërësi.

Nga ana tjetër nevoja për të gjykuar çështjet, respektimin e afateve procedurale, dhënien e drejtësisë në mënyrë të shpejtë kanë diktuar ndryshimet në ligjin 98/2016, por pa cenuar cilësinë profesionale të trupave dhe as të vendimmarrjes së gjykatave.

3.0 PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të Dekretit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, vlerësoi se Ligji nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”,

është miratuar në përputhshmëri të plotë me parimet kushtetuese dhe me votat e shumicës së anëtarëve të komisionit të pranishëm, vendosi rrëzimin e Dekretit nr.13017 datë 12.04.2021, “Për kthimin e ligjit nr. 46/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

RELATOR

KRYETAR

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA